

Në bazë të nenit 22 paragrafi (3) dhe nenit 63 paragrafi (3) të Ligjit të Pagesës së Pensioneve dhe të Kompensimeve Pensionale nga Sigurimi Pensional me Financim Kapital (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 11/2012, 147/2015 dhe 30/2016 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 103/2021), Këshilli i ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në mbledhjen e mbajtur më 27.7.2022, miratoi

Rregullore për rregullat dhe standardet minimale të tabelave të vdekshmërisë

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe standardet minimale për caktimin e tabelave të vdekshmërisë të cilat shoqëria pensionale i përdor gjatë përlllogaritjes së faktorit të anuitetit për pensione të shtyllës së dytë dhe kompensime pensionale të shtyllës së tretë (në tekstin e mëtutjeshëm: pensione) nëpërmjet tërheqjeve të programuara të përjetshme dhe të përkohshme.

Neni 2

Gjatë përcaktimit të tabelave të vdekshmërisë, shoqëria pensionale i përdor tabelat më të fundit zyrtare të vdekshmërisë dhe të dhënat tjera statistikore të përgatitura nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria pensionale mund t'i përshtatë tabelat e vdekshmërisë të paragrafit (1) të këtij neni duke u bazuar në të dhënat e veta lidhur me vdekshmërinë, nëse të dhënat e tilla janë statistikisht të rëndësishme, ose të përdorë tabela të tjera të vdekshmërisë, nëse konsideron se janë më të përshtatshme dhe janë përzgjedhur në drejtim të mbrojtjes më të madhe të shfrytëzuesve të pensionit.

Gjatë përcaktimit të tabelave të vdekshmërisë, shoqëria pensionale duhet të ketë parasysh specifikën e popullsisë së përbërë nga pensionistë të cilëve u paguhet pensioni nëpërmjet tërheqjeve të programuara.

Përveç të dhënave nga paragrafi (1), (2) dhe (3) të këtij neni, shoqëria pensionale gjatë përcaktimit të tabelave të vdekshmërisë duhet të ketë parasysh rritjen e pritshme të jetëgjatësisë së popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mund ta zgjasë jetëgjatësinë e pritshme më së shumti deri në tre vjet në lidhje me të dhënat e përdorura gjatë përcaktimit të tabelave të vdekshmërisë.

Neni 3

Tabelat e vdekshmërisë janë të specifikuara sipas gjinisë dhe moshës.

Tabelat e vdekshmërisë nuk përfshijnë kriteret e tjera përveç moshës dhe gjinisë së pensionistit.

Neni 4

Gjatë zgjedhjes së të dhënave për përcaktimin e tabelave për vdekshmërinë, shoqëria pensionale duhet të aplikojë shkallë të përkujdesjes të cilën do ta aplikojë njeri racional.

Neni 5

Tabelat e përdorura të vdekshmërisë dhe të gjitha përshtatjet duhet të publikohen në raportin vjetor nga aktuari i shoqërisë pensionale.

Neni 6

Me këtë rregullore shfuqizohet Rregullorja për rregullat dhe standardet minimale të tabelave të vdekshmërisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/2014).

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Nr. 01-1036/10

29.7.2022

Shkup

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve
Maksud Ali, d.v.